



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

**Departamenti i Informatikës** në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për **1 (një)** pozicion pune, personel akademik, me kohë të plotë, të kategorisë *asistent lektor*,

Kriteret e kandidatit të kategorisë *asistent lektor* janë si më poshtë:

### **Kandidati duhet të zotërojë këto kriteret të përgjithshme:**

- Të ketë përfunduar studimet universitare, Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, në Informatikë, Inxhinieri kompjuterash, Inxhinieri informatike, Teknologji e informacionit, Teknologji të informacionit dhe komunikimit, Shkenca kompjuterike ose në profile të njëvlerëshme me to. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
- Të ketë përfunduar studimet Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, me notë mesatare mbi 8.
- Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

### **Kritere të veçanta:**

- Të ketë aftësi të mira komunikuese të punës në grup;
- Të ketë përvojë në mësimdhënie në IAL dhe të jetë i angazhuar në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve në fushën e Informatikës. Referencat apo rekomandime nga titullarë të lënde përbëjnë avantazh;
- Preferohet të ketë publikime, trajnime si edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Publikimet do të vlerësohen vetëm nëse janë të lidhura me fushën e informatikës;
- Preferohet të jetë i specializuar në fushën e programimit apo teknologjisë web (përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet duke u mbështetur në nevojat aktuale të departamentit;
- Kandidati preferohet të njohë mirë gjuhën angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në protokoll (Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv) të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**30.01.2023 – 08.02.2023**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Minsitria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin;
- Fotokopje e njësuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njësuara me origjinalin;
- Referenca nga titullarë lëndësh
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (30.01.2023 – 08.02.2023) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,**

**Aplikim për pozicionin e punës:**

*Asistent lektor – Departamenti i Informatikës*

**Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit të Shkencave të Natyrës**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (13.02.2023 – 28.02.2023). Brenda kësaj periudhe kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

**Shënim:** Formularët për plotësim gjenden në adresën:

[www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion](http://www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion)